



Breaking News:

Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, gjatë 24 orëve të fundit

⏏ ⏪ ⏩



LajmetOperacionet

10/10/2024

Tiranë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Kus”

Tiranë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Kus”, nga Komisariati i Policisë Nr. 6.

Sekuestrohen 1 armë zjarri pushkë, 2 krëhra dhe sasi municioni luftarak, 1 kallëp tritoli së bashku me fitilin përcjellës dhe kapsollën, 2 granata sulmuese, 2 ndezës unifikues granatash dhe 1 mjet prerës (thikë).

Vihet në pranga poseduesi i tyre.

Shërbimet e Komisaritatit të Policisë Nr. 6, në vijim të punës për goditjen e paligjshmërisë në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara nga inteligjenca policore, se një shtetas posedonte armë dhe sende të tjera të jashtëligjshme në banesën e tij, në Kus, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Kus”.

Gjatë operacionit është arrestuar në flagrancë shtetasi B. M., banues në Kus, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” dhe “Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta”, parashikuar nga nenet 278/4 dhe 279 të Kodit Penal.

Gjatë kontrollit të banesës së shtetasit B. M., në fshatin Kus, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 1 armë zjarri pushkë, 2 krëhra dhe sasi municioni luftarak, 1 kallëp tritoli së bashku me fitilin përcjellës dhe kapsollën, 2 granata sulmuese, 2 ndezës unifikues granatash dhe 1 mjet prerës (thikë).

Materialet i kaluan Prokurorisë.

Kërko

Enter a word for search

Q

Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month

▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ Vuno, Himarë – Policia ndihmon 2 turistë gjermanë që kishin mbetur të bllokuar në zonën e quajtur “Gropat e Bufti”

DVP Durrës, gjatë 24 orëve të fundit ▶